



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT  
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

P.nr.1293/2015

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shpresa Emra, me pjesëmarrjen e sekretares juridike-procesmbajtëses Birsën Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. S nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1488/15 të dt. 29.06.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurori i Shtetit Elfete Purova dhe të akuzuarit, me datë 21.10.2016, publikisht mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

I akuzuari A. S nga i ati A' dhe e ëma A e lindur S, i lindur me në Prizren, ku edhe banon në rr., pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, i ve babë i 3 fëmijëve, identifikohet me letër njoftim nr. 1 shqiptar, shtetas i R të Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

Se prej datës së pavërtetuar e deri më datën 17.03.2015, në në Prizren, në shtëpinë e tij familjare, përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrejtit përcues të rrymës apo rrejtit të shpërndarjes, pa autoirizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte përmes kabllit duke anashkaluar njehsorin elektrik, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material në vlerë prej 337.43€.

Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së.

Andaj në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, dhe nenit 320 të KP-së, të akuzuarit A. S i shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale dhe

## DËNIMI ME GJOBË

Duke ia vërtetuar dënimi me gjobë në lartësi prej 140 (njëqindë e katërdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, gjykata këtë dënim do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim duke llogaritur 20 €, për një ditë burgimi, respektivisht me 7 (shtatë) ditë burgim.

E dëmtuara KEDS për realizimin e kërkesës pronësoresh juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar Aktakuzë kundër të akuzuarit A nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së.

Gjykata duke vepruar sipas Aktakuzës PP/II.nr.1488/15 të dt. 29.06.2016 ka caktuar shqyrtimin fillestar në të cilin i akuzuari A, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimi e provave.

Gjykata në shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se prej datës së pavërtetuar e deri më datën 17.03.2015, në Prizren, në shtëpinë e tij familjare, përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet përmes rrejtit përçues të rrymës apo rrejtit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte përmes kabllit duke anashkaluar njehsorin elektrik, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material në vlerë prej 337.43€.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar, vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 i KP-së, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me burgim me kusht në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej **1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale si dhe dënimin me gjobë në lartësi prej **140 Euro**.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë duke cekur se e pranon përgjegjësinë për këtë veprë pasi që njehsori është i regjistruar në emër të tij dhe nga kjo rrjedh edhe përgjegjësia objektive për të njëjtin. Ai është person i moshuar, pensionist, me dëgjim të dobët, i gjendjes së dobët ekonomike.

Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarit i shqiptoi sanksionet penale sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksionet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penale juridike të saj dhe se me këto sanksione do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Gjykata vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil e mori në harmoni me nenin 463 të KPP-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.


Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr.1293/15 të datës 21.10.2016**

**Sekretare Juridike**  
**Birsen Shoshani**

**Gjyqtari**  
**Shpresa Emra**



**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.